



Dren Puka është Drejtor i Hulumtimit dhe Avokimit në Fondacionin Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Ai ka mbi 10 vite përvojë në hartimin e kornizave teorike dhe empirike të hulumtimit dhe angazhimi në procese avokuese që synojnë të prodhojnë argumente dhe evidence për krijim të politikave publike përmes pjesëmarrjes më të gjerë qytetare, dhe krijimin e një ambienti përkrahës për zhvillim të shoqërisë civile.

Dreni ka qenë i angazhuar si Koordinator i Platformës CiviKos në periudhën 2010–2012, konkretisht në fazën e ri-aktivizimit së Platformës pas një periudhe të pezullimit të aktivitetit. Më pas, si përfaqësues i KCSF-së, ka qenë vazhdimisht i përfshirë në të gjitha proceset që lidhen me punën CiviKos, përfshirë pjesëmarrjen në grupin punues për hartimin e Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile, si dhe si anëtar i Këshillit për Monitorimin e zbatimit të kësaj strategjie. Përveç kësaj, ai ka luajtur rol kyç në komunikimin dhe përfaqësimin e interesave të anëtarëve të Platformës, duke prezantuar dhe diskutuar propozimet për politikat kyçe të Strategjisë me anëtarët e CiviKos – sidomos ato që ndërlidhen me fondet publike për OJQ-të, raportimin financiar, vullnetarizmin etj.

Në vitet e fundit, ndër të tjera, Dreni ka udhëhequr Programin për Angazhim Qytetar – një program përmes të cilit është siguruar financim afatgjatë për Platformën CiviKos, duke mundësuar kështu rritjen e qëndrueshmërisë së saj dhe thellimin e rolit të CiviKos si mekanizëm kyç i bashkëpunimit ndërmjet shoqërisë civile dhe institucioneve publike.

Dreni ka përfunduar studimet pasuniversitare në Politika të Edukimit dhe Lidership, me specializim në Metodologji Hulumtuese në University of Rochester, SHBA.